

---

## TERMAT E REFERENCËS

Rindërtim Portali, Mirëmbajtje dhe Menaxhim, Data entry  
Projekti “**Monitorimi i Kuvendit dhe veprimtarisë parlamentare 2021-2023**”

Instituti i Studimeve Politike (ISP) kërkon të kontraktojë **një ekspert të jashtëm për përgatitjen e raporteve periodike mbi aktivitetin parlamentar**, pjesë e projektit “Monitorimi i Kuvendit dhe veprimtarisë parlamentare 2021-2023”, që ISP do të implementojë me mbështetjen e Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim në Shqipëri me të cilën ISP ka nënshkruar një kontratë granti.

<b>Pozicioni / Shërbim</b>	Ekspert IT për mirëmbajtje portali
<b>Titulli i Projektit</b>	“Monitorimi i Kuvendit dhe veprimtarisë parlamentare 2021-2023”
<b>“Mbështetur:</b>	Projekti financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim në Shqipëri
<b>Lloji i Kontratës :</b>	Kontratë shërbimi
<b>Periodha e kontratës</b>	Shtator 2021 - mars 2023
<b>Koha e punës</b>	18 muaj

ISP me mbështetjen e Ambasadës Zvicerane dhe Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim do të implementojë projektin “Monitorimi i Kuvendit dhe veprimtarisë parlamentare 2021-2023” Ky projekt synon, Monitorimin e Kuvendit për të mundësuar transparencë dhe llogaridhënie përmes vlerësimit të programit të transparencës në Kuvend dhe efikasitetit të veprimtarisë së deputetëve dhe grupeve parlamentare në lidhje me detyrimet kushtetuese, aktet rregullatorë ligjore dhe të brendshme parlamentare.

Qëllimi kryesor është ndikimi pozitiv në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe aktivitetit përfaqësues të Kuvendit dhe deputetëve.

Në kuadër të zbatimit të këtij projekti, ISP hap thirrjen për angazhimin e një eksperti/e të informatikës për mirëmbajtjen e një ueb-site përfshirë rindërtimin, update-in dhe mirëmbajtjen. Eksperti/ja i angazhuar duhet të jetë i/e gatshëm të ofrojë suportin për mirëmbajtjen dhe funksionimin portalin [www.deputetim.al](http://www.deputetim.al), rindërtimin e site-it ose ndryshimin e seksioneve të webit duke e përshtatur atë me kërkesat dhe nevojat e projektit të

## ri “Monitorimi i Kuvendit dhe veprimtarisë parlamentare 2021-2023”.

Eksperti, bazuar në kërkesat dhe të dhënat e vendosura në dispozicion nga stafi zbatues i ISP, do të përmbushë shërbimet e mëposhtme:

- Të krijojë seksione te reja, rindërtojë, mirëmbajë dhe përditësojë portalin në funksion të projektit dhe backup të vazhdueshëm të të dhënave;
- Të mbështesë të gjithë ciklin jetësor të webit në internet për gjithë kohëzgjatjen e projektit (duke përfshirë konceptin, testimin, publikimin, ngarkimin e materialeve, ofrimin e mbështetjes teknike);
- Të lidhet rregullisht me koordinatorin e projektit/skuadrën e projektit dhe marr pjesë në takime kur është e nevojshme gjatë gjithë periudhës së zbatimit;
- Të kontribuojë në planifikimin dhe sugjerimin e veçorive/zgjidhjeve të reja;
- Të sigurojë përputhjen e produktit me legjislacionin në fuqi për të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e të dhënave;
- Të kujdeset për reflektimin e materialeve të nevojshme pjesë e seksioneve të ueb-site dhe t’ju kthejë përgjigje përdoruesve në kërkesat e tyre;
- Të mundësojë facilitimin e përdoruesve të ueb- site me përfaqësuesit e institucioneve shtetërore përgjegjëse të cilëve ju adresohen kërkesat/pyetjet e qytetarëve;
- Të adresojë drejt subjektit IT të kontraktuar, çdo keq-funksionim apo crash teknologjik që mund të pësojë ueb- site;

ISP inkurajon aplikimet nga kandidatë, të cilët janë të interesuar për t’u angazhuar si ekspertë në këtë proces dhe plotësojnë këto kriteret të aftësisë individuale, edukimit dhe aftësisë profesionale në vijim:

### **Aftësitë individuale**

1. Të jetë i/e pavarur, i/e paanshëm dhe me integritet;
2. Të jetë i/e përgjegjshëm për respektimin e detyrave dhe afatet e vendosura;
3. Të ketë aftësi të punojë nën presionin e kohës.
4. Shkathtësi të shkëlqyera analitike, ndërpersonale dhe komunikuese;

### **Kualifikimet dhe përvoja**

1. Diplomë Bachelor + Master në Shkencat Kompjuterike
2. Eksperiencë në menaxhimin apo administrimin e faqeve online në Facebook apo website të ndryshme të paktën 3 vjet;
3. Shembuj të faqeve të internetit të zhvilluara më parë;
4. Përvoja e mëparshme e punës me sektorin e OJQ-ve do të konsiderohet një aset.

### **Procesi i përzgjedhjes**

Përzgjedhja e aplikantit më të favorshëm do të jetë e brendshme dhe vendimi do të merret nga një komision vlerësimi prej 3 anëtarësh bazuar në Kriteret e mëposhtëm të vlerësimit

### **Dokumentat e Aplikimit:**

Aplikantët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e ekspertit duhet të dorëzojnë:

1. Shprehje interesi 1 fq.A4 ku të jenë pasqyruar dhe disa punë të mëparshme në formë linku;
2. Curriculum Vitae;
3. Ofertë Financiare e nënshkruar në LEK me një ndarje buxheti, sipas kategorive;
4. Diplomë

## Procedura e Vlerësimit

Kualifikimet dhe eksperiencia juaj duhet të jenë konform kërkesave të specifikuar në Termat e Referencës. CV juaj do të vlerësohet për përputhjen e eksperiencës dhe kualifikimeve tuaja me kriteret e vendosura dhe që lidhen me:

Kriteret e vlerësimit	Vlerat në përqindje
(i) Kualifikime të përgjithshme/ Eksperiencat e mëparshme	30 pikë
(ii) Përshtatshmëria me ToR në projekt;	40 pikë
(iii) Ofertë Financiare	30 pikë

REZULTATI TOTAL 100 pikë

Kandidati që vlerësohet me më shumë pikë, do të ftohet për nënshkrimin e kontratës.

Aplikantët mund të paraqesin çdo pyetje shtesë dhe/ose kërkesë për sqarime në formë elektronike në adresën e e-mailit [contactaips@gmail.com](mailto:contactaips@gmail.com).

ISP inkurajon ekspertët e interesuar që të dërgojnë deri në datën 25.10.2021, ora 12.00 në formë elektronike në adresën e e-mailit të ISP [contactaips@gmail.com](mailto:contactaips@gmail.com), me postë ose dorazi me zarf të mbyllur me përshkrimin sipër zarfit: Ofertë për ekspert web-i, në adresën: Rr "Luigj Gurakuqi", Shk. A, P.89 K.3, Ap 16, Tiranë dokumentacionin e mëposhtëm:

## Kostot dhe Pagesat

Kosto totale për sigurimin e këtij shërbimi për gjithë periudhën parashikohet të jetë 360,000 (treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë bruto për të gjithë periudhën e angazhimit. Mënyra e pagesës përcaktohet në Kontratën e Shërbimit pas paraqitjes së materialeve të realizuara nga eksperti për punën e kryer.

Të gjithë aplikuesit fitues apo jo fitues do të lajmërohen pas procedurës së përzgjedhjes, prandaj lutemi specifikoni qartë adresën e subjektit, e-mail ose një nr. kontakti.

## Instituti i Studimeve Politike

Projekt i mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim.



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC